



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 19 JANAR 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. JANUARA 2015. GODINE**

**JANAR - JANUAR
2015**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrt zakona o izmenama i dupunama Zakona br. 03/-087 o javnim preduzećima

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e Sesionit pranveror të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Rendi i ditës për seancën e sotme është përgatitur nga Kryesia e Kuvendit.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 99 deputetë.

Andaj, fillojmë me punimet e seancës plenare.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike

Deputetë të nderuar,
Lidhur me shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 14 janar 2015, njëzëri ka vendosur që Kuvendit t'i propozojë që shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike të bëhet me procedurë të përshpejtuar, pra me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Po ashtu, edhe Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka propozuar që shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike të bëhet me procedurë të përshpejtuar, pra me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Në ndërkohë, Qeveria si sponsorizues i këtij draft-ligji e ka një propozim tjetër.

E kisha ftuar kryeministrin Isa Mustafa që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozimin.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike është duke u përgatitur për një kohë të gjatë, për një periudhë të gjatë kohore. Ka qenë pjesë e aktivitetit kuvendor në mandatin e kaluar dhe po ashtu e kemi paraparë që të jetë pjesë edhe e këtij mandati.

Në ndërkohë, ne jemi ballafaquar me një problem të veçantë sa i përket të ardhmes së “Trepçës” dhe objektivi ynë themelor si Qeveri e Republikës së Kosovës është që të krijojmë kushte për riorganizimin e “Trepçës” dhe kushte që “Trepça” të punojë pa asnjë problem ligjor në të ardhmen.

Qëllimi themelor po ashtu është që të pamundësojnë procedurën e falimentimit të “Trepçës”, sepse konsiderojmë se kjo nuk është në interes të punëtorëve të “Trepçës”, nuk është në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe nuk është në interes të askujt.

Dhe, ne i kemi ndërmarrë të gjitha masat si Qeveria që t’jua propozojmë juve mënyrën më adekuate që në këtë moment ne ta parandalojmë që të aktivizohet procedura e falimentimit të “Trepçës”, ndërkaq, në ndërkohë, t’i marrim të gjitha masat që bashkërisht të vendosim se si do ta organizojmë “Trepçën” në të ardhmen.

Ne vetë kemi kërkuar nga Kuvendi dhe nga Kryesia e Kuvendit që kjo çështje të vihet në rend të dite. Në ndërkohë kemi konstatuar se janë shumë elemente të cilat kërkojnë që ne t’i shqyrtojmë, sidomos ato që kanë të bëjnë me obligimet, përkatësisht me detyrimet kreditore të kombinatit “Trepça”, e të cilat, sipas disa informatave mund të sillen deri 1,4 miliard euro, dhe për të cilat ne duhet të vendosin pas një analize më të qartë se si të adresohen ato detyrime kreditore.

Prandaj, kjo është arsyeja themelore që ne kërkojmë që sot në këtë mbledhje të mos shqyrtohet kjo pikë e rendit të ditës, që ne si Qeveri ta shqyrtojmë edhe një herë sot gjatë ditës këtë ligj, ta sjellim në Kuvend dhe që nesër Kuvendi i Republikës së Kosovës mund ta trajtojë edhe këtë ligj me propozimin, përkatësisht riadresimin që ne do t’ia bëjmë Kuvendit.

Ndërkaq, propozojmë që të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit dhe atë e kërkoj në përputhje të nenit 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që sot, më 19 janar, të mbahet mbledhje në orën 14:00 dhe ta shqyrtojmë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me të cilën ne mendojmë se mund t’i plotësojmë kushtet në mënyrë që të mos mund të aktivizohen procedurat e falemintimit të Kombinatit “Trepça”. Ndërkaq ligjin do të jua sjellim nesër, me propozim që me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike, Ndërmarrja Publike “Trepça” të organizohet me ligj të veçantë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Në rrethana të tilla, kur propozuesi, në këtë rast Qeveria e Republikës së Kosovës e tërheq projektligjin, nuk kemi materie për diskutim. I kisha ftuar shefat e grupeve parlamentare dhe Kryesinë që pas gjysmë ore të takohemi në sallën 301. E kemi një propozim të sponsorizuesit që sot, pasi do ta kemi në orën 14:00, në qoftë se Kryesia dhe shefat e grupeve parlamentare vendosim të kemi mbledhje sot në orën 14:00. Atëherë për gjysmë ore në sallën 301.

(Reagime nga salla)

Do ta vazhdojmë sot debatin, pasi kemi kërkesë. Nuk përfundon!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*